



## Njoftim për protokollin ndryshues të METD

### Protokolli ndryshues i Konventës në mes të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës

*Njoftim lidhur me përmbajtjen e protokollit ndryshues të Marrëveshjes për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal*

Administrata Tatimore e Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të METD-së, ku në kuadër të kësaj ofron edhe shërbime për tatimpaguesit të cilët mbulohen nga këto marrëveshje.

Me datë 27 Tetor 2020 është dekretuar ratifikimi i protokollit ndryshues i Marrëveshjes për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal, e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, më datë 02.10.2020.

Aktualisht, Republika e Kosovës ka dy METD me Republikën e Shqipërisë:

Marrëveshja për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) në mes të UNMIK-ut dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal e cila është e zbatueshme që nga data 1 Janar 2005, dhe

Marrëveshja për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal e cila është e zbatueshme që nga data 1 Janar 2016.

Marrëveshja e vitit 1 Janar 2016 është ndryshuar me protokollin e lartpërmendur, i cili plotëson preambulën e marrëveshjes, dispozitat e Nenit 1, Nenit 10, Nenit 12, Nenit 25 dhe Nenit 26.

Neni 1 i Protokollit ndryshues e plotëson preambulën e marrëveshjes.

Neni 2 i Protokollit ndryshues e plotëson Nenin 1 të METD “Personat e përfshirë” ku janë shtuar paragrafët 2 dhe 3 të cilët nuk i kufizojnë të drejtat e shtetit kontraktues për të tatimuar rezidentët e tyre, përveç në lidhje me përfitimet e dhëna sipas paragrafit 3 të nenit 7, paragrafit 2 të Nenit 9 dhe Neneve 18, 19, 22, 23, 24 dhe 27”.

Neni 3 i Protokollit ndryshues e plotëson Nenin 10 të METD “Dividendët” ku është shtuar paragrafi 1.1. sipas të cilit dividendët mund të taten edhe në shtetin e rezidencës, por duke iu përmbajtur edhe parimit të pronarit përfitues.

Neni 4 i Protokollit ndryshues e plotëson Nenin 12 të METD “Të ardhurat nga e drejta e pronësisë” ku janë shtuar paragrafët 1, 1.1 dhe 3.1 sipas të cilëve të ardhurat nga e drejta e pronësisë mund të tatimohen edhe në shtetin burimor, por duke iu përmbajtur edhe parimit të pronarit përfitues.

Neni 5 i Protokollit ndryshues e plotëson Nenin 25 të METD “Shkëmbimi i informacionit” ku janë shtuar paragrafët 4 dhe 5 sipas të cilëve kur kërkohet informacion nga njëri shtet kontraktues atëherë shteti tjetër kontraktues do të përdorë masat e tij për mbledhjen e informacionit të kërkuar, pavarësisht se Shteti tjetër mund të mos ketë nevojë për këtë informacion për qëllimet e veta tatimore dhe një shtet kontraktues nuk mund të refuzojë të sigurojë informacione vetëm sepse nuk ka interes të brendshëm për atë informacion.

Neni 6 i Protokollit ndryshues e shton në METD Nenin 26/1 ‘E drejta për përfitime’ sipas të cilit një rezident i një Shteti Kontraktues nuk ka të drejtë për një përfitim, përveç nëse ai rezident është ‘person i kualifikuar’ siç definohet në paragrafin 2.

Këto ndryshime do të fillojnë të zbatohen duke filluar nga data 1 janar 2021.